



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë 10 Prill 2018

Prishtinë

Për : z. Ramush Haradinaj
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Nga: Beqir Fejzullahu 
Zëvendësministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Lënda: RAPORT I PUNËS PËR PERIUdhËN JANAR-MARS 2018

I nderuar z. Kryeministër,

Më lejoni që zyrtarisht të paraqes para jush raportin tim të punës për periudhën Janar – Mars 2018 në cilësinë e Zëvendës Ministrit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ky raport është i bazuar në mandatin e MAPL-së së përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, duke marrë parasysh misionin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe konform objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026, si dhe planit vjetor të punës për vitin 2018.

Në këtë raport të punës janë përmbledhur të gjitha aktivitetet të cilat kam realizuar gjatë periudhës Janar-Mars 2018.

Aktivitetet të cilat kam realizuar gjatë periudhës Janar-Mars 2018, janë zhvilluar në bashkëpunim me departamentet dhe njësit e MAPL-së, siç janë:

- Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave;
- Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale;
- Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
- Departamenti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal;
- Departamenti për Shërbime të Përgjithshme Administrative;
- Divizioni për komunikim publik;
- Divizioni për auditim të brendshëm;
- Divizioni i prokurimit;

Gjatë kësaj periudhe në marrëveshje me Ministrinë e MAPL-së kam zëvendësuar Ministrinë në mbledhjet e mbajtura të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe kam kontrolluar dhe aprovuar aktet komunale siç janë:

- 216 lëndë për konfirmimin e ligjshmërisë së akteve të kuvendeve komunale të Republikës së Kosovës;
- 41 lëndë, kërkesa për rishqyrtimin e ligjshmërisë të cilat nuk kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 29 lëndë, përgjigje në kërkesa qoftë nga përfaqësuesit e organeve komunale si dhe nga kërkesat individuale nga qytetarët e komunave të Republikës së Kosovës dhe
- 2 shkresa shpjeguese për parashtruesit;

Sa i përket akteve të ligjshmërisë gjatë kësaj periudhe ka pasur një numër të madh të akteve sepse ka qenë faza përmbyllëse e implementimit të rezultateve zgjedhore lokale dhe konsolidimi i organeve komunale, si dhe shumica e lëndëve të kthyer për rishqyrtim të ligjshmërisë kanë qenë në mos zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore (05\L-020) nga kuvendet komunale.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kam ofruar përgjigje:

- në kërkesat e Avokatit të Popullit;
- në kërkesat e qytetarëve;
- në kërkesat e organeve komunale;

Po ashtu kam qenë pjesëmarrës në këto takime/konferenca si në vijim:

- Me datë 10 Janar 2018, kam realizuar vizitën në komunën e Ferizajit, ku gjatë këtij takimi nga kryetari i komunës z. Aliu jam njoftuar me sfidat e komunës dhe jemi dakorduar që të ngrisim nivelin e bashkëpunimit në mes të MAPL-së dhe nivelit

lokal në mënyrë që të ngrisin funksionimin dhe performancën në qeverisjen lokale.

- Me datë 17 Janar 2018, kam qenë pjesëmarrës në konferencën për bashkëpunim territorial, e mbajtur në Tiranë- Shqipëri, konferencë e cila është organizuar nga Ministri për Evropë dhe Punë të Jashtme në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë z.Ditmir Bushati, ku në emër të MAPL-së në këtë konferencë kam pasur fjalë rasti.
- Më datë 19 janar 2018, kam qenë pjesëmarrës në konferencën përmbyllëse IPA I në Podgoricë (Mali i Zi), konferencë e cila është organizuar nga Ministri për Integritet Evropian në Qeverinë e Malit të Zi z. Pejoviq, ku në emër të MAPL-së në këtë konferencë kam pasur fjalë rasti. Si konkluzion i përbashkët i punimeve të kësaj konference ishte se nga zbatimi i suksesshëm i këtyre projekteve, të dy vendet janë dëshmuar si të suksesshme në zbatimin e programit të IPA I për bashkëpunim ndërkufitar(BNK) në mes të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës ku janë arritur objektivat e synuara. Në kuadër të këtij programi IPA I janë realizuar 9 projekte me vlerë financiare prej 3.2 milion euro, si dhe të arriturat e përbashkëta vetëm sa e forcojnë bashkëpunimin dhe partneritetin edhe në realizimin e programit për bashkëpunim ndërkufitar IPA II gjatë periudhës 2014 - 2020.
- Nga data 23 shkurt - 25 shkurt 2018, kam qenë pjesëmarrës në konferencën e përbashkët me kryetarët e komunave me temë " Të arriturat dhe sfidat në fushën e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, konferenca është mbajtur në Budva- Mal të Zi dhe në fokus kishte kryetarët e posazgjedhur të komunave. Në bashkëpunim me ministrat dhe përfaqësues të ministrive të linjës, janë shkëmbyer informata dhe me qëllim të adresimit të sfidave të komunave dhe lehtësimit në përmbushjen e obligimeve ligjore në nivelin lokal. Konferenca është përmbyllur me dakordimin e pjesëmarrësve në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimin e nivelit qendror me atë lokale për të rritur funksionimin dhe performancën në qeverisjen lokale.

- Me datë 06 Shkurt 2018, kam pritur në takim Kryetarin e Komunës së Kaçanikut z. Besim Ilazin, ku gjatë këtij takimi jam njoftuar me sfidat e komunës dhe kemi shprehur gatishmëri për bashkëpunim të ndërsjellët për të tejkaluar së bashku këto sfida në të cilat gjendet Komuna e Kaçanikut.
- Me datë 23 Mars 2018, kam pritur në takim Kryetarin e Komunës së Drenasit (Glllogocit) z. Ramiz Lladovcin, ku së bashku nënshkruam marveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit të komunës për rregullimin e ndriqimit publik duke aplikuar edhe masat e energjisë efiqente. MAPL është e përkushtuar të ofroj ndihmën e nevojshme financiare për komunat e Republikës së Kosovës me qëllim të përmirësimit të kushteteve për të hapur rrugë zhvillimit ekonomik lokal.
- Me datë 27 Mars 2018, kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Junikut z. Agron Kuqin, ku së bashku nënshkruam marveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit të komunës për asfaltimin e rrugëve lokale në vlerë financiare prej 130.000 euro në bashkëfinancim ku 90.000 euro financon MAPL-ja dhe 30.000 euro komuna e Junikut.

MAPL është e përkushtuar të mbështes edhe në të ardhmen komunën e Junikut.
- Me datë 29 Mars 2018, kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Deqanit z. Bashkim Ramosaj ku së bashku nënshkruam marveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit për rregullimin e infrastruktureës komunale kanalizimi i ujrave të zeza në zonën urbane në vlerë financiare prej 124.502 euro, MAPL bashkëfinancon këtë projekt me 74.000 euro.
- Me datë 29 Mars 2018 kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Malishevës z. Ragip Begaj ku së bashku kemi nënshkruar marveshjen e mirëkuptimit për

financimine projektit të infrastrukturës komunale "Ndërtimi i trotuarit në Dragobil në vlerë financiare prej 72.000 euro", MAPL bashkëfinancon këtë projekt me 37.000 euro. MAPL është e përkushtuar të mbështes edhe në të ardhmën komunën e Malishevës.

- Me datë 29.03.2018 kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Obiliqit z. Xhafer Gashin ku së bashku kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për financimine projektit "Asfaltimi i rrugës "Nuhi Kelmendi" në vlerë financiare prej 50.000 euro.
- Me datë 29.03.2018 kam pritur kryetarin e komunës së Fushë Kosovës z. Burim Berishën ku kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për financimin e projektit "Ndërtimi i stazave të qendrës rekreative" në vlerë financiare prej 150.000 euro. MAPL-ja këtë projektë e financon me 50.000euro.
- Me date 03.04.2018 kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Gjakovës z. Ardian Gjinin me të cilin kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për bashkëfinancim të projektit ""Ndërtimi i rrugës lokale Qafë Prush" në vlerë financiare prej 208.088 euro.
- Me datë 03.04.2018 kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Mitrovicës së jugut z. Agim Bahtirin ku kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Shupkocv" në vlerë financiare prej 128.227 euro.
- Me datë 03.04.2018 kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Klinës z. Zenun Elezaj ku kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për bashkë financimin e projektit "Renovimi i objektit të komunës" në vlerë financiare prej 60.000 euro.
- Me datë 04.04.2018 kam pritur në takim Kryetarin e komunës së Kamenicës z. Qëndron Kastratin ku kemi nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për

financimin e projektit "Renovimi i Qendrës së Mjeksis Familjare" në vlerë financiare prej 70.000 euro.

Sqarim shtesë:

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet MAPL-së dhe Projektit të DEMOS-it me Komunitat përfituese për financimin e projekteve të ndryshme të infrastrukturës në vlerë financiare prej 2.331.999 euro . Komunitat e përfshirë në këto projekte sipas performancës së tyre janë:

- Ferizaj, Prizreni, Peja, Vushtrri, Podujevë, Istog, Lipjan, Rahovec, Dragash, Kaçanik, Suharekë, Malishevë, Klinë, Shtime, Skenderaj, Viti, Hani i Elezit, Mitrovicë e Jugut, Junik, Novobërdë, Obiliq, Graçanicë, Mamushë dhe Shtërpçë.

Me kriteret e performancës sipas DEMOS-it dhe fondit të MAPL-së është bërë ndarja e balancuar e investimeve kapitale për komunitat e Republikës së Kosovës.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe, jam kujdesur për kompletimin dhe finalizimin e Koncept Dokumentit për Themelimin e Akademisë për Qeverisje Lokale, të cilën e kemi përcjellë në qeveri për miratim. Ky koncept ka qenë i punuar më parë dhe janë kaluar fazat e konsultimeve paraprake, ku themelimi i kësaj akademie do të ndikonte në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal në fusha specifike në mënyrë që të përmbushen objektivat strategjike 2016-2026 për vetëqeverisje lokale, gjithashtu do të ndikonte edhe në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe në ngritjen e shkallës së funksionimit të organeve komunale në Republikën e Kosovës.

Ne mbesim të përkushtuar në punën tonë drejt avancimit të qeverisjes lokale në vend, me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së organeve të komunave duke siguruar shërbime sa më cilësore dhe më afër qytetarëve.

Singerisht,